



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Duke u bazuar në Rregulloren Nr.01/2022 për Avancimin në Karrierë dhe Transferimin e Nëpunësve në Komisionin e Pavarur të Mediave , KPM shpall:

KONKURS TË BRENDSHËM **Për plotësimin e vendit të lirë të punës**

Titulli i vendit të punës: Drejtor i Departamentit të Administratës dhe Financave

Klasa e pozitës ; Drejtues/e i/e Mesëm

Koeficienti / Paga: 8.5

Nr i kërkuar : 1

Departamenti: Departamenti i Administratës dhe Financave

Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat

Numri i referencës: 2308/661/ADM/n.a

Vendi i punës: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Mbështet dhe ofron këshilla për udhëheqësin më të lartë administrativ të institucionit dhe/ose titullarin e institucionit për politikën dhe objektivat e institucionit në fushën e përgjegjësisë së Departamentit të Administratës dhe Financave.
2. Identifikon nevojat për zhvillimin e politikave dhe objektivave të institucionit dhe bën rekomandime brenda përgjegjësisë së DAF-it.
3. Drejton dhe mbikëqyrë të gjitha aktivitetet e DAF-it dhe siguron funksionim efikas të tij.
4. Është përgjegjës për përcaktimin e objektivave dhe planifikimin e veprimtarisë së DAF-it dhe zgjidhjen e problemeve profesionale që lidhen me DAF-in.
5. Menaxhon me burimet njerëzore dhe buxhetin e Departamentit, si dhe identifikon nevojat për ngritjen e kapaciteteve të stafit të DAF-it.
6. Organizon dhe shpërndan punën për varësit e tij dhe menaxhon realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë që duhen përmbushur në përputhje me objektivat dhe përgjegjësitë e DAF-it.
7. Udhëzon stafin në përmbushjen e aktiviteteve të përditshme të Departamentit dhe siguron që kjo veprimtari të jetë në përputhje me legjislacionin, politikën institucionale dhe standardet përkatëse.
8. Me autorizimin e mbikëqyrësit, përfaqëson institucionin në takime pune, konferenca në fushën e përgjegjësisë së DAF-it të cilin e udhëheq.
9. Bën vlerësimin e rezultateve në punë për stafin nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të tij dhe identifikon nevojat për zhvillimin e kapaciteteve të tyre përmes trajnimeve.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

1. Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 4 vite ose 3+2 vite studime në fushën e ekonomise apo administratë publike.
2. Së paku gjashtë (6) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku tri (3) vite në pozita drejtuese.

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:

1. Aftësi të larta organizative, drejtuese dhe për hartim politikash.
2. Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive të nivelit të lartë analitik dhe zgjidhjes së problemeve.
3. Njohuri të gjëra lidhur me fushën e përgjegjësisë së Departamentit, menaxhimin e buxhetit dhe të shërbimit civil.
4. Aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie mirëbesimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon.
5. Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses projektet e Departamentit.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Jetëshkrimi - CV; Letra motivuese; Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; Kopjet e dëshmimeve mbi trajnimet relevante; Kopjet e dëshmisë së punësimit si dhe kopje të vlerësimeve të punës për dy (2) vitet e fundit. Në rastet kur diploma është e lëshuar nga një shtet jashtë Kosovës, atëherë duhet të jetë e barasvlershme dhe e njohur me ligjet në Kosovë.

“Komisioni i Pavarur i Mediave ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë nëpunësit e Zyrës Ekzekutive dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë nëpunësit, dhe se komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në të gjitha strukturat dhe njësitë organizative të Zyrës Ekzekutive.”

Afati i aplikimit është prej 15/08/2023 deri më datë 22/08/2023, deri në orën 16:00

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Aplikacionet dorëzohen në Komisionin e Pavarur të Mediave, Rr. Perandori Justinian nr.124. “Qyteza Pejton” 10000 Prishtinë. Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në numrin e tel: +383 38 245 031, prej orës 08:00 – 16:00, ose vizitoni ueb faqen e KPM-së, në linkun: www.kpm-ks.org